



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 maj 2013  
Nr.ref.:RK416/13

## **AKTVENDIM PËR PAPARANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KIo 2/13**

Parashtrues

**Halil Mazreku**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 691/01, të 11 dhjetorit 2007, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 24/09, të 12 majit 2011**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Halil Mazreku, me vendbanim në lagjen “Arbana”, komuna e Prizrenit.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 691/01, e 11 dhjetorit 2007, dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 24/09, e 12 majit 2011.
3. Ndërsa, në rastin konkret, mjet i fundit juridik, për shkak të respektimit të afatit katër (4) mujor, konsiderohet Njoftimi KMLC nr. 45/11, i 6 korrikut 2011, i Prokurorit të Shtetit të Kosovës, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 25 korrik 2011.

## **Objekti i çështjes**

4. Çështja bazë e kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 691/2001, të 11 dhjetorit 2007, dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 24/09, të 12 majit 2011, përkitazi me të drejtën e parashtruesit.

## **Baza juridike**

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe rregulli 28 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

## **Procedura në Gjykatë**

6. Më 9 nëntor 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesë të pakompletuar në Gjykatë.
7. Më 11 nëntor 2011, Gjykata kërkoi nga parashtruesi dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm, përfshirë këtu edhe vendimet gjyqësore të gjykatave të rregullta.
8. Më 8 janar 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, duke ia bashkëngjitur asaj edhe dokumentacionin e kërkuar.
9. Më 18 janar 2013, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën Themelore në Prizren dhe Gjykatën e Apelit në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës KIo2/13 në regjistrin përkatës të Gjykatës.
10. Më 30 janar 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues dhe caktoi edhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues, që e zëvendëson gjyqtarja Snezhana Botusharova), Ivan Čukalović (anëtar) dhe Prof dr. Enver Hasani (anëtar).
11. Më 5 shkurt 2013, Gjykata kërkoi dokumentacion shtesë nga Gjykata Themelore në Prizren.
12. Më 5 shkurt 2013, Gjykata Themelore e Prizrenit dërgoi dokumentacionin e kërkuar.

13. Më 30 prill 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

14. Më 5 dhjetor 2001, parashtruesi ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Prizren, në bazë të kontratës mbi shitblerjen (kontrata e pavërtetuar), e lidhur më 6 janar 1984, ndërmjet z. Halil Mazrekut (blerësi) dhe, tani të ndjerit, Bajram Sadik Berishës (shitësi). Parashtruesi pohon se pas blerjes është bërë pronar i patundshmërisë (ngastra kadastrale nr. 402, ZK Arbanë, me kulturë arë e kl. IV, në vendin e quajtur "Nën fshat, te rruga", me sipërfaqe 1.17,00 ha, ngastër kadastrale të cilën shitësi e kishte marrë në emër të ndërrimit me parcelën 146 dhe me parcelën 383 nga KBI "Progres-Export" në Prizren). Të paditurit, gjegjësisht familjarët e ish-pronarit, tani të ndjerit Bajram Berisha, nëpërmjet kontestit civil, kanë arritur ta rikthejnë ngastrën kadastrale me nr. 383, në vendin e quajtur "Nën fshat, te rruga", arë e kl. IV, me sipërfaqe 0.74,33 ha, në bazë të fletës poseduese nr. 254, KK Arbanë, e cila evidencohet në emër të të paditurve. Parashtruesi, nëpërmjet padisë së ushtruar, ka kërkuar vërtetimin e kontratës së shitblerjes së patundshmërisë dhe njohjen e pronësisë mbi patundshmërinë e blerë, si dhe regjistrimin e tij si pronar të saj.
15. Më 11 dhjetor 2007, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktgjykimin C. nr. 691/01, e 11 dhjetor 2007, refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit për vërtetimin e pronësisë për të cilën parashtruesi pretendon se e kishte blerë nga tashmë i ndjeri Bajram Berisha (shitësi). Me aktgjykimin e njëjtë, gjykata në fjalë refuzoi ankesën e ushtruar nga të paditurit, gjegjësisht nga familjarët e të ndjerit Bajram Berisha, për kthimin e parcelës nr. 146, në vendin e quajtur "Bregu, te rruga", me kulturë arë jopjellore, me sipërfaqe 30 m<sup>2</sup>, dhe me kulturë arë e kl. IV, me sipërfaqe 0.65,03 hektarë, dhe parcelën nr. 383, në vendin e quajtur "Nën fshat, te rruga", me kulturë arë e kl. IV, me sipërfaqe 0.74,33 hektarë – të gjitha së bashku me sipërfaqe 1.39,66 hektarë, sipas listës poseduese nr. 252, ZK Arbanë.
16. Më 12 maj 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin Ac. nr. 24/09, refuzoi ankesën e ushtruar nga parashtruesi dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 691/2001, e 11 dhjetorit 2007. Gjykata e Qarkut, në këtë rast, konstatoi se vendimi i gjykatës së shkalles së parë nuk përbënte shkelje esenciale të procedurës kontestimore, siç pretendohet nga ankuesit, për faktin që shkalla e parë kishte vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe, po ashtu, kishte aplikuar drejt ligjin në këtë çështje juridike.
17. Më 23 qershor 2011, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës ushtroi të drejtën e tij me propozim që Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës të iniciojë procedurë për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, kundër Aktgjykimit të fuqisë së prerë të Gjykatës Komunale në Prizren, C. Nr. 691/2001, të 11 dhjetorit 2007, dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. Nr. 24/09, të 12 majit 2011.
18. Më 6 korrik 2011, Prokurori i Shtetit, nëpërmjet Njoftimit KMLC nr. 45/11, refuzoi propozimin e parashtruesit përkitazi me ngritjen e kërkesës për mbrojtje



të ligjshmërisë kundër vendimit të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë, pasi nuk gjeti bazë të mjaftueshme ligjore për ngritjen e saj.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta, me vendimet e tyre, ia kanë shkelur atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Parashtruesi nuk ka specifikuar në kërkesë se cilat të drejta kushtetuese i janë shkelur nga autoritetet, përkatësisht nga gjykatat e rregullta. Ai vetëm ka përmendur se gjykatat e rregullta, gjegjësisht Gjykata e Qarkut në Prizren, ka aplikuar gabimisht dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe dispozitat e Ligjit për ndërrimin dhe për plotësimin e Ligjit për qarkullimin e patundshmërive.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

20. Gjykata vlerëson së pari nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi konteston vendimin e shkallës së parë dhe vendimin e shkallës së dytë, si akte konkrete të autoriteteve publike. Parashtruesi, në kërkesën e tij, nuk ka specifikuar saktësisht shkeljet kushtetuese të të drejtave të tij. Megjithatë, Gjykata vëren se bëhet fjalë për të drejtat pronësore. Parashtruesi, gjithashtu, ka përmendur se çfarë dëshiron të arrijë nëpërmjet kërkesës se tij dhe ka bashkëngjitur vendime të ndryshme dhe informata e dokumente të tjera mbështetëse.

21. Sa i përket të drejtës në pronë, neni 46 i Kushtetutës, në mënyrë specifike përcakton:

*“Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve eksproprijohej”. (Shih paragrafin 3, e nenit 46).*

22. Gjykata Kushtetuese vëren se bazat e ankesës së parashtruesit, si në shkallën e parë, si në shkallën e dytë, ashtu edhe në propozimin për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, përmbajnë pretendime që kanë të bëjnë me shkelje substanciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit të aplikuar në rastin konkret.
23. Gjykata Kushtetuese konsideron se këto pretendime mund të jenë të fushës së ligjshmërisë. Kërkesa duhet të ngrihet dhe të argumentohet mbi bazën e ankimit kushtetues (kushtetutshmërisë), duke përmendur saktësisht dispozitat kushtetuese me të cilat pretendohen shkeljet e të drejtave kushtetuese të parashtruesit a parashtruesve.

24. Megjithatë, Gjykata analizon dhe vlerëson nëse parashtruesi ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, duke i mbështetur me prova pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë. Parashtruesi duhet të qartësojë në kërkesën e tij se cilat të drejta kushtetuese pretendon se i janë shkelur me aktin e autoritetit a të autoriteteve publike. Përkritazi me këtë, Gjykata vëren se neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese qartazi përcakton se *“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar”*.
25. Për më tepër, rregulli 36.2 i Rregullores së punës, përcakton:
- “(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
- a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;*
  - b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*
  - c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose*
  - d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”*.
26. Së fundi, neni 46 i Ligjit përcakton që *“Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7, të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore”*.
27. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk tregon pse dhe si gjykatat e rregullta ia kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe as që ka ofruar prova për shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese. Gjykata rikujton që rasti duhet të ndërtohet në baza kushtetuese, në mënyrë që kjo gjykatë të ndërhyjë.
28. Është kompetencë e gjykatave të rregullta të vlerësojë ligjshmërinë e një dokumenti, në këtë rast të kontratës për shitblerjen e patundshmërisë, sipas bindjes së tyre, konform ligjit, bazuar në faktet dhe në provat që ofrojnë palët e përfshira në procedurë të rregullt gjyqësor.
29. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me lajthitje të fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), gjoja të kryera nga gjykatat e rregullta, përveç nëse dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë. Prandaj, në këtë rast, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së tretë. Është detyrë dhe obligim i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I*).
30. Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë vetëm nëse provat para gjykatave dhe para organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat

në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtuesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (*Shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991*).

31. Në të vërtetë, parashtuesi nuk i ka mbështetur pretendimet e tij në baza kushtetuese, duke treguar pse dhe si Gjykata e Supreme ia ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga Gjykata Supreme. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të gjejë pse dhe si ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme (*Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009*).
32. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata gjen se kërkesa nuk i përmbush kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe të rregullit 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës dhe, si e tillë, është qartazi e pabazuar.
33. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 20 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 56.2 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.


### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 48 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36.2 (b) dhe (d) dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores, më 31 maj 2013, njëzëri

### **VENDOSI**

- I. TA REFUZOJ kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtari raportues**



Altay Suroy



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani